



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës për Produktet Biocide.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Ministry of Environment and Spatial Planning -
Ministarstvo Sredine i Prostornong Planiranja

**KONCEPT DOKUMENT PËR RREGULLIMIN E FUSHES SE
PRODUKTEVE BIOCIDIE**

Prishtinë, 2016

Kapitulli 1: Hyrje

Produktet biocide janë të nevojshme për kontrollin e organizmave që janë të dëmshme për shëndetin e njeriut apo të kafshëve dhe për kontrollin e organizmave që dëmtojnë materiale natyrore ose të prodhuara. Produktet biocide për shkak të vetive të tyre të metodat e përdorimit mund të shkaktojnë rrezik për njerëzit dhe mjedisin.

Hartimi, i këtij koncept dokumenti është një përpjekje në interes të konsistencës për të ofruar sa më shumë njohuri dhe informata lidhur me administrimin e produkteve biocide, sidomos masat që do të duhet të merren për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave ekzistuese, me qëllim të krijimit të mudësisë ligjore për menaxhimi e produkteve biocide në Republikë e Kosovës, çdo her duke pasur parasysh harmonizimin e rregulave edhe me shtet tjera.

Qëllimi i këtij koncept dokumenti është të identifikoj qeshtjet me kruciale që ne të ardhmen të përmirësojë lëvizjen e lirë të produkteve biocide brenda në tregun e Kosovës dhe me gjere, duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së grupeve vulnerabël, siç janë gratë shtatzëna dhe fëmijët. Ky koncept dokument do të bazohet në parimin parandalues për të siguruar që prodhimet e produkteve biocide dhe qarkullimi i tyre në tregun e Kosovës nuk kanë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut ose të kafshëve ose efekteve të dëmshme mbi mjedisin.

Nje nga dokumentet që autorizon në nxjerrjen eventuale të akteve për produktet biocide është Kushtetuta e Kosovës dhe qëllimi kryesor i këtij koncept dokumenti është që të analizoj , identifikoj dhe të përcaktoj qasjen për të krijuar kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdorën për prodhimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës.

Ndryshimet për administrimin e produkteve biocide kryesisht do të behën në fushën e legjislacionit sepse në këtë fushë gjithashtu kanë pasuar shume ndryshime e legjislacionin e Bashkësisë Evropianë për kimikate, sidomos në ndryshimi i tërësishëm (anulimi) i Direktivës 98/8/EC, për produktet biocide, cila është zëvendësuar në tërësi nga Rregullorja (EU) nr. 528/2012/ për produktet biocide.

Kështu që ndryshimet e bëra në fushën e produkteve biocide në nivel të BE – se, automatikisht krijojnë disëharmonit me rregullat e legjislacionin nacional për produktet biocide, që janë vërejtë mangësi dhe vështërsi në rregullat ligjore lidhur me procesin e regjistrimit, autorizimit, importimit, si dhe mbikqyrjes dhe inspektimit të produkteve biocide.

Procesi i hartimit të koncept dokumentit do të udhëhiqet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Institucione tjera relevante që ndërlidhen me këtë fushën e kimikateve.

Kapitulli 2:

Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Produktet biocide janë të nevojshme për kontrollin e organizmave që janë të dëmshme për shëndetin e njeriut apo të kafshëve dhe për kontrollin e organizmave që dëmtojnë materiale natyrore ose të prodhuara. Produktet biocide, megjithatë, për shkak të karakteristikave të tyre të brendshme dhe mënyrat e përdorimit mund të përbëjnë rrezik për njerëzit, kafshët dhe mjedisin.

Produktet biocide bëjnë pjesë në kimikate që posedojnë karakteristika të rrezikshme, të cilat janë në numër shumë të madhë nuk duhet të vihen në dispozicion në treg ose të përdoren përveç nëse autorizohet në përputhje me Rregulloret e BE-se për biocide, respektivisht Ligjin për produkte biocide. Produktet e trajtuara nuk duhet të vendosen në treg nëse të gjitha substancat aktive të përfshira në produktet biocide që ato përmbajnë, nuk janë miratuar në përputhje me rregullat e reja për menaxhimin e produkteve biocide.

Problemi:

Deri me tani në Kosovë administrimi i produkteve biocideve është bërë përmes Ligjit për produktet biocide nr. 03/L-119, dispozitat e të cilit nuk janë të mjaftueshme që të i plotësojnë nevojat për menaxhimin e produkteve biocide dhe ishte dhe pjesërisht në përputhshmëri me legjislacionin e BE - Direktiva Evropiane për produktet biocide.

Duke marrë parasysh ndryshimet e mëdha që janë bërë në rregullat ekzistuese, sidomos anulimi i Direktivës 98/8/EC, andaj një ligj i ndryshuar konsiderohet të jetë instrumenti i duhur ligjor për të vënë/krijuar rregulla të qarta, të hollësishme dhe drejtpërdrejt e zbatueshme për menaxhimin e produkteve biocide.

Për të arritur sigurinë për mjedisin dhe shëndetin nga produktet biocide është e nevojshme për të krijuar një listë të substancave aktive të miratuara në BE për përdorimin e produkteve biocide. Kjo listë është e domosdoshme të aprovohet dhe respektohet edhe në Kosovë, sepse përmes sajë rregullohet informacioni për palët e interesuara që duhet të aplikojnë për autorizimin e produkteve biocide në përbërjen e të cilave është një substancë e veçantë aktive e përfshirë në atë listë.

Po synohet që të plotësojmë kërkesat e Acquis komunitare për të siguruar përafrimin dhe zbatimin të kërkesave ligjore nga legjislacioni i BE-së.

Dispozitat e me të cilat do të duhet rregullohet fusha e produkteve biocide do të jenë kryesisht në përputhje me dispozitat këtyre rregullore të BE-së:

- Rregullorja (EU) Nr. 528/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi disponueshmërinë në treg dhe përdorimin e produkteve biocide (GZ L 167, 27.6.2012, fq. 1).

- Rregullorja (EC) nr. 1831/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 shtator 2003 mbi aditivët e ushqimit (OJ L 268, 2003/10/18, f. 29).
- Rregullorja (EC) nr. 1333/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 2008 mbi aditivëve të ushqimit (OJ L 354, 31.12.2008, fq. 16).
- Rregullorja (EC) nr. 1935/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 tetor 2004 mbi materialet dhe artikujt që do të jenë në kontakt me ushqimin dhe shfuqizimin e Direktivës 80/590 / EEC dhe 89/109 / (EEC OJ L 338, 2004/11/13, p 4.).
- Rregullorja (EC) nr. 1272/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 2008 mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve, ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivës 67/548 / EEC dhe Direktivën 1999/45 / EC dhe ndryshimin e Rregullores (EC) nr. 1907/2006 (OJ L 353, 31.12.2008, fq. 1).
- Rregullorja (EC) nr. 1907/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 dhjetorit 2006 në lidhje me regjistrimin, vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimi i kimikateve (REACH), krijimin e një Agjencinë Kimikateve Evropiane dhe ndryshon Direktivën 1999/45 / EC dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 793/93 dhe Rregullorja e Komisionit (EC) nr. 1488/94 dhe Direktiva e Këshillit 76/769 / EEC dhe Direktiva e Komisionit 91/155 / EEC, 93/67 / EEC, 93/105 / EC dhe 2000/21 / EC (OJ L 396, 2006/12/30, f. 1).
- Rregullorja (BE) Nr. 528/2012 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, Qëllimi i së cilës është për të përmirësuar funksionimin e tregut të brendshëm për produktet biocide, si dhe për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së njerëzve, kafshëve dhe mjedisit, hyri në fuqi më 01 shtator 2013 dhe ajo zëvendëson dhe shfuqizon Direktivën Produkte biocide 98/8 / KE lidhur me Vendasja e PB është në treg.

Nga këto Rregullore për produktet biocide do të derivojnë dhe akte ligjore dhe nënligjore me të cilat dote të plotësohen procedurat e lejes për prodhimin, importin, formulimin dhe përdorimin e produkteve biocide ne Republikën e Kosoves.

Kapitulli 3:

Synimet dhe objektivat

Një synim tjetër më specifik është krijimi i kushteve për arsimimin e vazhdueshëm, me qëllim të krijohen specialist të fushes së kimikateve dhe njekohsishte edukimin dhe ndergjeksimin e popullates lidhur me rreziqet nga përdorimi i helmeve siç janë produktet biocide. Me krijimin e këtyre kushteve do të rriten edhe llogaridhëni nga ana e pjesëmarrësve në procesin e menaxhimit të produkteve biocide. Me menaxhimin e drejt dhe rregullimin e tregut të produkteve biocide arrihet një harmonizim i rregullave me shtetet e rajonit dhe ato të Bashkimit Evropian dhe gjithë ashtu i nënshtrohen Standardeve të Harmonizuara Globale (GHS), që janë në një nivel ekuivalent me atë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është propozimi i një politike të re për rregullimin e menaxhimit të produkteve të biocide. Ky menaxhim do të bëhet përmes krijimit të kornizës së përshtatshme ligjore dhe vendosjes së procedurave të nevojshme për lejet për prodhim, import, formulim dhe përdorim të produkteve Biocide në Republikën e Kosovës. Gjithashtu duhet të sigurohet një proces i mirëfillte i nxjerrjes së lejeve të cekura dhe vazhdimisht të përmirësohet ambienti i sigurisë nga rreziku i përdorimit të produkteve biocide. Njëkohësisht do të ngritet shkalla e zbatimit të standardeve për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Qytetarët mund të zgjedhin shërbimet me produkte biocide nga personat e kualifikuar, të cilët paraprakisht i janë nënshtruar një procesi rigoroz të licencimit të personave juridik për dhënien e shërbimeve për Dezinfektim, Deratizim dhe Dekontaminim, si dhe shërbime të tjera me Produkte Biocide.

Objektivat kryesorë të shtruar në koncept dokument janë:

- Definimi i qartë i kompetencave edhe përgjegjësi ndërinstitucionale për administrimin e produkteve biocide;
- Përcaktimi i detyrimeve për monitorimin e kimikateve të rrezikshme, produkteve biocide zbatimit dhe monitorimit të tyre etj;
- Harmonizimi i rregullave me Aquis komunitare;
- Definimi më i mirë i detyrimeve për personat fizik dhe juridikë lidhur me administrimin e kimikateve në Republikën e Kosovës, duke pasur për qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit;

Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti është të përmirësojë lëvizjen e lirë të produkteve biocide, duke siguruar një nivel më të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së grupeve ndijeshme, ndër to gratë shtatzëna, fëmijët etj.

Rregullat që do vendosen lidhur me menaxhimin e produkteve duhen bazuar në parimin parandalues me qëllim për të siguruar se vendosja e në treg e substancave aktive dhe të produkteve biocide në Republikën e Kosovës nuk kanë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut ose të kafshëve ose efekteve të dëmshme mbi mjedisin.

Për të eliminuar sa më shumë pengesat për daljen në treg të produkteve biocide, do të jetë e nevojshme të miratohen rregullat për autorizimin e substancave aktive dhe vënien në dispozicion në treg dhe përdorim të produkteve biocide.

Të gjitha llojet e produkteve të cilat ishin të mbuluara më parë nga Direktiva për produkte biocide janë brenda fushëveprimit të Rregullores për produkte biocide Nr. 528/2012(BE) e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, me përjashtim të prezervativë për ushqim dhe lëndës së parë për ushqime (ish llojit të produktit 20).

Ky lloj produkti (ish llojit të produktit 20) është hequr nga objekti dhe është i mbuluar nga legjislacioni tjetër të BE-së. Përshkrimet për disa lloje të produkteve biocid, janë ndryshuar dhe janë zgjeruar, në krahasim me përshkrimin në Direktivë dhe Ligjin (egzistues) nr.03/L-119.

Tani në Rregulloren (BE) Nr. 528/2012, mbulohen 22 lloje të produkteve biocide.

Këto lloje gjenden në Aneksin V, të Rregullores, që do të përfshihen në legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe janë të sistemuara në katër (4) grupe kryesore:

Grupi kryesor 1: Dezinfektuesit;

Grupi kryesor 2: Preservativët;

Grupi kryesor 3: Kontroluesit e dëmtuesve;

Grupi kryesor 4: Produkte tjera biocide;

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, konsideron se rregullimi i fushës së produkteve biocide patjetër duhet të jetë i përfshirë me shtetet e rajonit dhe shtete anëtare të Bashkimit Evropian, sepse tregu i produkteve në shumicën e rasteve zhvillohet në këto hapësira

Kapitulli 4:

Opsionet

Opsionet e parashtruara më poshtë e reflektojnë gjendjen ekzistuese e cila nuk i përmbushë kushtet dhe standardet e diskutuara, por po ashtu edhe mënyrat e përmirësimit të njëjtës.

Opsioni i parë: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Mos ndryshimi i gjendjes aktuale nënkupton lënien në fuqi të Ligjit për produktet biocide, dhe sistemit aktual të administrimit të produkteve biocide i cili nuk është funksional.

Grupi punues ka shqyrtuar mundësinë e mos ndryshimit të gjendjes lidhur me rregullat e vendosura me pare në Kosovë për administrimin e produkteve biocide. Gjithsesi, Kjo gjendje mund edhe të vazhdojë, por veshetësit në tregun e përbashkët të rajonit dhe BE –se , sigurisht që në disa raste do të paraqiten mospërputhshmëria me rregullat e ndryshuara se fundi në këtë fushë.

Opsioni i Dytë: Rregullimi i pjesshëm i administrimit të produkteve biocide

Një opsion tjetër që është shqyrtuar gjatë përgatitjes së këtij koncepti dokumenti është edhe rregullimi i pjesshëm administrimit të produkteve biocide.

Grupi punues ka shqyrtuar mundësinë e ndryshimeve të pjesëshme, në fushën e administrimit të produkteve biocide, e sidomos për ndryshimin e pjesëshëm të Ligjit ekzistues, Si opsion , ishte

i mundshëm por jo edhe i mjaftuar sepse ndryshimet e bëra ne legjislacionin e BE-se ishin shume te mëdha.

Opsioni i Tretë:

Plotësimin dhe ndryshimi i politikave për respektivisht Ligjit për produktet biocide në përputhshmëri me Rregulloren e (BE) Nr. 528/2012 të Komisionit dhe Këshillit Evropian.

Grupi punues ka shqyrtuar alternative për ndryshimin e politikave për administrimin e produkteve biocide. Pasi qe janë analizuar dhe shqyrtuar qeshtjet me ndikim ne fushen perkatese, eshte konstatuar se ndryshimi i politikave dhe harmonizimi i tyre me rregulat e BE-se mund te behet vetëm duke ndryshualne theb Ligjin egzistues te produkteve biocide i cili perkunder perbajtjes se dispozitave pozitive, ne esence tani nuk është ne përputhshmëri me legjislacionin e BE-se.

Kapitulli 5:

Përmbledhje e opsioneve

Ruajtja e gjendjes ekzistuese që nënkupton mos ndryshimin e gjendjes aktuale në aspektin e menaxhimit të produkteve biocide. Ligji ekzistues nuk do të jetë i përshtatur me kërkesat e rregullores së BE-se dhe gjithashtu nga aspekti i procedurave për vënien e produkteve biocide ne treg, ato nuk janë kompletuar. Kjo do te paraqet pengesa ne zhvillimin e tregut normal te produkteve biocide , sidomos për importin dhe eksportin e tyre.

Plotësimi i pjesërishëm i legjislacionit. Pasi që legjislacioi i BE-së është dryshuar në tërësi, atëher nuk do të jetë veprim i duhur që pjesërisht të ndryshohet, sepse nuk do të mbuloj të gjitha procedurat.

Plotësimi dhe ndryshimi i legjislacionit në fuqi sipas afateve të kërkuara do të kishte një efekt të duhur sepse do te përfshihen të gjitha dispozitat relevantë te Rregullores së BE-së. (Tabela V).

Përmbledhja e opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1 Status-quo	Opsioni 2 plotësim ndryshimi i kornizës aktuale	Opsioni 3 Hartimi i Ligjit të ri
Karakteristikat kryesore të opsionit	Ruajtja e gjendjes ekzistuese që nënkupton mos ndryshimin fare të gjendjes aktuale, apo Mos ndryshimi i Ligjit për produktet biocide.	Ndryshimi i pjesërishëm i politikave per administrimie produkteve biocide apo Ligjit për produktet biocide	Plotësimi i politikave për administrimine produkteve biocide dhe hartimin e Ligjit të ri për produktet biocide/ në përputhshmëri me Direktivat dhe Rregulloret (Iartëcekura) të Komisionit dhe Këshillit Evropian. Përshtatja e kushteve për zbatim ne Republikën e Kosovës

			(RK)
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	Përfshihen të gjitha komunitetet në RK	Përfshihen të gjitha komunitetet RK	Përfshihen të gjitha komunitetet RK
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	MMPH	MMPH	MMPH
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	MMPH	MMPH	MMPH
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Ligjit për produktet biocide Ligji për kimikate Ligji për mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025.	Plotesim ndryshim i Ligjit për produktet biocide	Plotësimin dhe ndryshimi i Ligjit për produktet biocide në përputhshmëri me Direktivat dhe Rregulloret
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Takime me pale te interesit për ndryshim dhe plotesim me te shpejte te këtij Ligji.	Parashihet fushate promovuese	Parashihet fushate promovuese
Udhëzimet	Ne harmoni me legjislacionin e BE	Ne harmoni me legjislacionin e BE	Ne harmoni me legjislacionin e BE
Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni	Është ne fuqi	nuk do të ka ndryshime dhe nuk afatizohet ky opsion	Deri ne fund te viti 2017

Kapitulli 6:

Analiza e opsioneve

Opsioni i parë:

Opsioni status kohe (asnjë ndryshim) – Pas analizës së këtij opsioni, nuk vërehet ndonjë përfitim i konsiderueshëm dhe i matshëm nga ky opsion.

Opsioni të vazhdohet me ligjin ekzistues është opsion i papranueshëm sepse ligji në fuqi nr. 03/L-119, tashti konsiderohet i pa kompletuar dhe gjatë zbatimit të tije disa qështje të rëndësishme nuk do të mund të funksionalizohet as me akte nënligjore sepse nuk është siguruar baza e tyre ligjore e mjaftuar.

Mos përfshirja e obligimeve që dalin nga Legjislacioni i BE për produktet biocide nr. 03/L-119 si dhe masave për përshtatje në legjislacionin e kimikateve në përgjithësi dhe menaxhimin e rrezikut nga produktet biocide. Në këtë rast Ligji nuk do të jetë i përshtatur me kërkesat e rregullorës së BE dhe gjithashtu nga aspekti i procedurave për vënjen e produkteve biocide e treg nuk janë

kompletura.

Opsioni i dytë:

Rregullimi i Pjesshëm i administrimit të produkteve biocide sipas këtij opsioni askush nuk do të përfitoj në mënyrë të drejtë, mbikëqyrja do të jetë jo e plotë, nuk do ekzistojnë procedurat adekuate ndeshkuese, rregulla të bollshme dhe adekuate për autorizimin e venies së produkteve biocide në treg, dhenies së lejeve etj, nga i njëjti osin përfitimet janë vetëm për disa.

Andaj, Opsioni tjetër i mundshëm - amandamentimi dhe plotësim i Ligjitegzistues për produktet biocide nr. 03/L-119 i propozuar gjithashtu është konsideruar si i papërshatshëm.

Aryeja qëndron në faktin se përmbajtja e Ligjit për produktet biocide nr. 03/L-119 dotë ndryshoj në vëllim më shumë se 80% dhe poashtu do të ndryshoj edhe nga aspekti struktural i kapitujve/krerëve dhe neneve. Plotësimi i pjesërishëm i legjislacionit.

Pasi që legjislacioni i BE-së është ndryshuar në tersi, atëherë nuk do të jetë veprim i duhur që pjesërisht të ndryshohet, sepse nuk do të mbulojë të gjitha procedurat.

Opsioni i tretë:

Ndryshimi i politikës ekzistuese – Përfitimet konsistojnë në themelimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm të administrimit të produkteve biocide, caktimin e mekanizmit për mbikëqyrje dhe edukim të vazhdueshëm, sistem të dhenies së lejeve autorizim të produkteve biocide. Nga ky Opsion do të përfitonin si institucionet kompanite dhe vete qytetarët e Kosovës në tërësi, sidomos nga aspekti i mbrojtjes së mjedisteve dhe shëndetit.

Grupi punues dhe MMPH kanë rekomanduar si opsion me të arsyeshëm, Opsionin e tretë që është Plotësimi dhe hartimi i Ligjit të ri për produktet biocide, Nnxjerrja e Ligjit të ri që është ligj kornizë nga i cili do të dalin edhe disa Rregullore, Udhëzime Administrative dhe udhëzues teknik për përdorimin dhe ruajtjen e sigurt të produkteve biocide.

Hartimi dhe fuqizimi i Ligjit do të ishte në vijë të plotë me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullave për menaxhimin e produkteve biocide, që do të ishte në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe vendeve të rajonit.

Plotësimi dhe ndryshimi i legjislacionit në fuqi sipas afateve të kërkuara do të kishte një efekt të duhur sepse do të përfaqësojë të gjitha dispozitat relevante të Rregullorës së BE-së.

Kosto:

Miratimi i ndryshimit për hartimin e draftit të ri të Ligjit për produktet biocide nuk ka një kosto shtese dhe mund të konkludohet se nuk ka implikime të theksuara financiare.

Me këtë ligj do të krijohen procedura të thjeshta administrative dhe të shpejta për dhënjen e autorizimit për vënjene produkteve biocide në treg dhe lejeve për importin, eksportin, prodhimin dhe përdorimin apo dhenies së shërbimeve të produkteve biocide.

Zbatimi i Ligjit të ri për produkte biocide edhe më tej do të kërkojë mjete financiare nga buxheti i Kosovës për atë që do të mbulojë shpenzimet e zakonshme për zyrtarët kompetent të kësaj fushe dhe shpenzimet eventuale që do të kërkojnë gjatë hartimit të Ligjit dhe akteve nënligjore në trevjeçarit e parë pas miratimit të këtij ligji.

Nga ky ligj do të zbatohet një taksë administrative aplikuesit për miratimin e substancës aktive, si dhe për autorizimin e produkteve biocide. Gjithashtu taksa do të paguhet edhe për prodhuesin, importuesin, përdoruesin dhe formulatorin e produkteve biocidedo, të cilët do të paguajnë gjatë marrjes së lejes / autorizimit për vënjene treg, për veprimtarinë e tyre me produktet biocide. Kjo taksë do të duket si me poshtë:

1. Për marrjen e Lejes për import dhe eksport të produkteve biocide duhet paguar taksën administrative në vlerë prej dhjetë (10) euro;
2. Për marrjen e Lejes për prodhimin e produkteve biocide duhet paguar taksën administrative në vlerë prej pesëdhjetë (50) euro;
3. Për marrjen e Lejes për magazinimin e produkteve biocide duhet paguar taksën administrative në vlerë prej njëzet (20) euro;
4. Për marrjen e Lejes për përdorimin e produkteve biocide duhet paguar taksën administrative në vlerë prej dhjetë (10) euro.

Mjetet e grumbulluara nga taksa administrative sipas pikës 1,2,3,4, derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kostoja financiare të merret sipas deklaratës financiare në tab:

FORMULARI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT BUXHETOR

Kapitulli 7: Konsultimi

MMPH është një prej institucioneve kyçe, koordinimi me të cilin ishte i domosdoshëm për përgatitjen e këtij koncept dokumenti.

Për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji janë konsultuar departamentet brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe është arritur përfundimi se duhet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për produktet biocidive.

Po ashtu, gjatë hartimit të këtij Koncept Dokumenti, grupi punues në kuadër të MMPH ka zhvilluar disa konsultime paraprake me disa institucione dhe palë të interesuara sikurse:

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,
- Ministria e Shëndetësisë,
- Ministria financave,
- Agjensioni i ushqimit dhe Veterines të Kosovës
- Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Arkitekturës;
- Ekspertë të fushës
- Agjensioi i Mbrojtjes së mjedisit të Kosovës

Nevoja për hartimin e ligjit ka rrjedhë gjatë konsultimit me palët tjera, dhe gjatë konsultimeve të legjislacionit relevant dhe BE-së, është identifikuar nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, në mënyrë që do të lehtësonte zbatimin e tij.

Ligji ekzistues është një ligj kornizë i cili nuk i përcakton në mënyrë të detajuar dhe të plotë çështjet e administrimit të produkteve biocidive.

Nga palët e interesuara shpesh herë është kërkuar që ligji të kompletohet, rregullohet sidomos për rregullimin e dispozitave për nxjerrjen e lejeve, për çka është paraqitur nevoja që ne të mendojmë për ndryshime të ligjit dhe plotësimin të tij edhe me çështje që duhet plotësuar edhe në raportin e progresit dhe ekspert të tjerë. Kompanitë që janë konsultuar lidhur me nevojat e ndryshimit të ligjit për produktet biocidive janë edhe kompanitë që merren me importin dhe dhënie të shërbimit me produktet biocidive:

„Eramed” Ntp, Prishtine,
„Fauna ‘’ Shpk, Gjilan,
„EchoTech,, Shpk. Suharekë,
„Ekologjia’’ NTP, Ferizaj

Konsultimet profesionale dhe përkrahja e këtij projekt ligji dotë bëhet edhe nga Komisioni Evropian me programit të TAIEX, me angazhimin e një eksperti të lemise se kimikateve të rrezikshme përkatësisht produkteve biocide, për të cilin grupi punues propozon që të kërkohet për së paku për 10 ditë punë përkrahje nga eksperti duke filluar që nga fundi i muajit janar ose shkurt.

Nga konsultimi me palët relevante është konstatuar se hartimi i një Ligji të ri është nevojë e domosdoshme dhe do të jetë në pajtim me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullave në mbrojtën e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimi i produkteve biocide si dhe përafrimi me *aacquis communitaire* të BE-se.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve (vlerësimi i pasojave të secilit opsion)

Propozuesi ka shqyrtuar një sërë alternativa të mundshme për të gjitha opsionet e lartcekura, por dy opsionet e para nuk mund të vendosen sepse të mos bësh ndryshim fare, apo për një ndryshim të pjeserishëm nuk do të jepet mundësia që fusha e produkteve biocide të menaxhohet sipas kërkesave dhe standardeve më të avancuara, sidomos sipas kërkesave të Sistemit Global të Harmonizuar, i pershtatur dhe komplementuar edhe nga legjislacioni i BE-se.

Opsioni 1 dhe 2 nuk rekomandohet meqenëse është në fuqi që disa vite tashmë dhe si i tillë pas ndryshimeve të legjislacionit në nivel të BE-se, do të krijohen zbrastesi për implementimin e tij në praktikë. Për më tepër, ruajtja e status kohës, apo ndryshim i pjesshëm, në raport me miratimin e Projektligjit të ri nuk do të jenë të arsyeshme sepse me ligjin e ri do të përcaktohen kriteret e nevojshme për një administrim më të drejtë të produkteve biocide.

Opsioni i rekomanduar është: Ndryshimi dhe hartimi i draft ligjit të ri për produktet biocide që nënkupton opsionin e tretë, pasi që Ligji ekzistues nuk i plotëson të gjitha kriteret për menaxhimin e produkteve biocide, kështu që është paraqitur nevojë për ndryshime dhe plotësime më shumë se 80%. Në veçati ndryshimi duhet të ndodhë, pasi legjislacioni i BE-se ka pësuar ndryshim shumë të madhe me anulimin e Direktivës 98/8/EC, e cila zëvendësohet në teresi nga Rregullorja- (EU) Nr. 528/2012 në lidhje me vënien në dispozicion në treg dhe të përdorin të produkteve biocide,

Kështu opsioni për hartim të draftit të ri do të ishte opsion më i përshtatshëm sepse parashihet që të futen kapituj të tërë të ri me shume dispozita që me parë nuk ishin përfshirë në Ligjin ekzistues, andaj edhe kjo ndikon që të hartohet ligji të ri për produktet biocide të jete i pranueshëm.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Rekomandimi që i bëhet Qeverisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes këtij Koncept Dokumenti është hartimi dhe miratimi i Ligjit të ri për administrimin e produkteve biocide, sipas kërkesave dhe standardeve të BE dhe ato ndërkombëtare (sistemit GHS).

Bazuar në këtë koncept dokument, pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, MMPH do të kryesoj grupin punues në të cilin do të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Ministrinë tjera relevante, komfor Rregullores së Punës së Qeverisë dhe do të konsultoj palët tjera të interesit.

Personi përgjegjës do të jetë Zyrtari kyç i cili koordinon punën me Departamentet tjera të MMPH si dhe marrjen e opinionit të brendshëm për të filluar me konsultimet paraprake dhe publike me Ministrinë tjera lidhur me hartimin e Ligjit të ri për produkte biocide.

Kapitulli 10: Komunikimi

Komunikimi bëhet gjatë dy fazave të ndryshme e që janë – gjatë draftimit të këtij dokumenti por edhe në fazën pasi të jetë hartuar.

Për më tepër, një mundësi shtesë e cila po ashtu nuk kërkon fonde dhe i qaset një grupi të madh njerëzish, do të ishte komunikimi dhe informimi i komunave dhe popullatës përmes rrjetit të informimit që funksionon në kuadër të MMPH.

Fusha e produkteve biocide është shumë fitim prurëse për ekonominë që merren me prodhimin, importimin e produkteve biocide. Por nga aspekti i ndjeshmërisë për rreziqet e mundshme dhe për ndikimin në shëndetin e njeriut dhe mjedisit, publiku është shumë i interesuar që produktet biocide të rrezikshme të administrohen sipas rregullave dhe standardeve më të avancuara.

Komunikimi me publikun për ligjin e biocideve nga MMPH do të bëhet në kuadër të zhvillimit të programit për informimin dhe vetëdijesimin e publikut lidhur me synimet dhe objektivat për administrimin e produkteve biocide si dhe arsyet për nxjerrjen e Projektligjit për Biocide.

Para se të dërgohet në Qeveri për miratim drafti i parë i projektligjit do të publikohet në ueb-faqen e MMPH-së për qëllime të konsultimit të akterëve të tjerë të interesua

